

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët, Nesrin Lushta kryetare, Valdete Daka dhe Agim Maliqi anëtarë, me bashkëpunëtorin profesional Bujar Balaj, procesmbajtës, në çështjen penale të dënuarit V.Gj. nga Klina për shkak të veprës penale uzurpim i paligjshëm i pronës së paluajtshme nga neni 332 par.1 të KPK, duke vendosur sipas kërkesë për mbrojtjen të ligjshmërisë të mbrojtësit të dënuarit av. N.S., ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Pejë - Dega në Klinë P.nr.131/2015 datë 2.11.2016 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës PA1.nr.57/2017 datë 8.6.2017, në seancën e kolegjit të mbajtur 14.3.2018, morri këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësit të dënuarit V.Gj., ushtruar kundër aktgjykimit Gjykatës Themelore në Pejë - Dega në Klinë P.nr.131/2015 datë 2.11.2016 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës PA1.nr.57/2017 datë 8.6.2017.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Pejë-Dega në Klinë P.nr.131/2015 datë 02.11.2016 e ka shpall fajtor të dënuarin V.Gj., për shkak të veprës penale uzurpim i paligjshëm i pronës së paluajtshme nga neni 332 par.1 të KPK, dhe për këtë vepër e ka gjykuar me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajsh, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i dënuari në afat prej 1 (një) viti nuk kryen vepër penale të re. I dënuari është obliguar që në afat prej 2 (dy) muajsh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit t ia kthej në posedim dhe shfrytëzim të lirë të dëmtuarit lokal afarist të evidentuar në listën posedues me numër P-71006024-10-7186 e nën kërcënim të përmbarimit me dhunë, e nëse i dënuari nuk ia kthen në posedim lokal e cekur në afatin e paraparë, dënimi me burgim do të ekzekutohet. I dënuari është obliguar që ti paguaj shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor në shumën prej 160 € e në afat prej 15 ditësh nga plotfuqishmëria e aktgjykimit e nën kërcënim të përmbarimit me dhunë. I dëmtuari J.B. për realizimin e kërkesë pasurore- juridike është udhëzuar në kontest të rregullt civil.

Në procedurën ankimore Gjykata e Apelit të Kosovë me aktgjykimin PA1.nr.57/2017 datë 8.6.2017, ka refuzuar si të pabazuar ankesën e të dënuarit V.Gj., kurse aktgjykimi i shkallës së parë është vërtetuar.

Kundër këtyre aktgjykimeve kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë ka paraqitur mbrojtësi i të dënuarit av. N.S., nga Prishtina, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkeljes së ligjit penal dhe vendimit mbi sanksionin penal, me propozim që aktgjykimet e kundërshtuara të anulohen dhe çështja ti kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim si dhe të shtyhet ekzekutim i aktgjykimit të formës së prerë deri sa mos të vendoset lidhur me kërkesën.

Prokuroria e Shtetit me parashtresën KMLP.II.nr.188/2017 datë 05.10.2017, ka propozuar që kërkesa të refuzohet si e pabazë.

Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit pasi shqyrtoi të gjitha shkresat e çështjes në kuptim të dispozitës së nenit 435 par.1 dhe 436 par.1 të KPPK, dhe pasi vlerësoi pretendimet nga kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë, konstatoi se :

Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është e pabazuar.

Në kërkesë mbrojtësi i të dënuarit, av. N.S., pretendon se të dy aktgjykimet janë të përfshira me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale të cilët kryesisht kanë të bëjnë me nenin 384 par.1 nënpar.1.12 të KPPK. Këto shkelje konsistojnë në faktin se dispozitivi i aktgjykimit është në kundërshtim me arsyetimin dhe me faktet e vërtetuara nga gjykata, sepse i dënuari ka shfrytëzuar lokalin afarist duke u bazuar në kontratën mbi qiranë të lidhur në mes të V. dhe A.Gj., dhe komunës së Klinës sipas një vendimi të UNMIK-ut për paluajtshmërinë të cilës nuk i është ditur titullari që nga viti 2000 deri 2015. Nga ky dispozitiv del se i dënuari ka uzurpuar lokalin afarist në vitin 2015, dhe se lokalin e kanë shfrytëzuar në bazë të kontratës që nga viti 2000 e ky konstatim përjashton ekzistimin e çfarëdo elementi të veprës penale me që i dënuari e ka shfrytëzuar lokalin në bazë të një autorizimi të dhënë nga A.Gj. (vëllai i tij) duke i paguar qira komunës së Klinës. Këto janë kundërshtime të cilat paraqiten në aktgjykim sepse nuk është e qartë kush ishte shfrytëzues i lokalit i pandehuri apo i vëllai i tij dhe nëse kjo është e vërtetë se lokali është marr me qira atëherë pse kemi të bëjmë me çështje penale kur këto janë marrëdhënie juridiko-civile.

Në kërkesë po ashtu pretendohet se ndaj të dënuarit është shkel ligji penal nga se nga shkresat e çështjes rrjedhë se ndjekja penale kundër të pandehurit është parashkruar sepse vepra e supozuar penale ka qenë e kryer në vitin 2010 ndërsa sanksioni për këtë veprë penale është me gjobë apo me dënim burgu deri në 2 (dy) vjet prandaj parashkrimi i ndjekjes penale është arritur nga fakti se kanë kaluar 3 (tri) vjet nga koha kur është kryer vepra penale e supozuar.

Nga të gjitha këto del se ndaj të dënuarit është shkel ligji penal me që i njëjti lokalin e ka shfrytëzuar në bazë të autorizimit të vëllait të tij, A., dhe se në fakt ai fare nuk është personi që ka kryer veprën penale të pretenduar.

Gjykata Supreme e Kosovës pasi vlerësoi pretendimet nga kërkesa dhe duke u bazuar në shkresat e çështjes gjeti se i dënuari V.Gj. ka shfrytëzuar lokalin afarist të quajtur "F." në bazë të kontratës për qiradhënie të lidhur në mes të A.Gj. (vëllait të të dënuarit) dhe komunës së Klinës e sipas një vendimi të UNMIK-ut për paluajtëshmëri që nuk i dihet titullari dhe këtë lokal e ka shfrytëzuar nga viti 2000 deri 2015. Në vitin 2007 kur A.Gj., shkon në shtetin e Norvegjisë i dënuari e shfrytëzon lokalin në bazë të një autorizimi të dhënë nga njëjti e deri me datën 26.11.2014, e duke i paguar qira Komunës së Klinës e në bazë të kontratës për qiradhënie të cekur më lartë.

Që nga viti 2007 i dënuari e ka pas nën menaxhim të plot lokalin afarist dhe i njëjti i ka kryer të gjitha çështjet të cilat kanë pasur të bëjnë me pagesën e qirasë dhe menaxhimin funksional të lokalit. Me datën 26.11.2014, të dënuarit i është ndërprerë kontrata e qiradhënës nga Kuvendi Komunal i Klinës me arsyetim se lokali afaristë është shitur dhe se tani e tutje pronarë është i dëmtuari J.B.. Kontrata mbi shitblerjen është vërtetuar në Gjykatën Komunale në Klinë dhe në vitin 2015 i dëmtuari J.B. ka bërë bartjen e pronësisë në emër të tij në bazë të certifikatës nr.11/3219 të datës 23.6.2015, të lëshuar nga Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronësi të komunës së Klinës. Në të njëjtën kohë i dëmtuari është paraqitur në lokalin afaristë të cilin i dënuari ende e mban në shfrytëzim, e ka njoftuar gojarisht se ai është pronar i lokalit dhe se të njëjtin duhet ta liroj. Mirëpo i dënuari që nga viti 2015 edhe më tutje e ka shfrytëzuar këtë lokal afarist. Të gjitha këto vërtetohen nga provat të cilat gjenden në shkresat e çështjes, nga kontratat mbi qiramarrje, nga deklaratat e të dënuarit, dëmtuarit J.B., dëshmitarëve – ish pronarit të lokalit afarist, Z.Zh., dëshmitarit I.M., B.Sh., A.S.. Nga të gjitha këto nuk është kontestues fakti se lokali afarist ka qenë pronë e Z.Zh. dhe se i dëmtuari J.B. është bërë pronar i këtij lokali në bazë të kontratës mbi shitblerje të vërtetuar në gjykatë. Po ashtu nuk është kontestues fakti se që nga viti 1999 e deri me datë 26.11.2014 lokali është shfrytëzuar nga A. dhe V.Gj. e në bazë të një kontrate mbi qiradhënien në mes të komunës së Klinës dhe A.Gj.. Po ashtu nuk është kontestues fakti se nga viti 2007 këtë lokal e shfrytëzua V.Gj. në bazë të autorizimit të dhënë nga A.Gj. si dhe nuk është kontestues fakti se i dënuari V.Gj. për kundër faktit se ka qenë i njoftuari nga i dëmtuari J.B. se tani ai është pronar, dhe përkundër faktit se kontrata për qiradhënie është ndërprere nga ana e komunës së Klinës, ka vazhduar ta shfrytëzoj lokalin afarist.

Gjykata Supreme konsideron se as një nga pretendimet nga kërkesa nuk qëndrojnë sepse dispozitivi i aktgjykimit i gjykatës së shkallës së parë është i qartë dhe në përputhje të plotë me arsyetimin e dhënë, i njëjti përmban të gjitha elementet që përbejnë figurën e veprës penale për të cilën edhe i dënuari është shpallur fajtor, ndërsa me të drejtë Gjykata e Apelit i pranon në tërësi arsyetimet e dhëna nga gjykata e shkallës së parë.

Sa i përket pretendimit se në dëm të të dënuarit është shkelur ligji penal me që ka ardhur deri te parashkrimi i ndjekjes penale, kjo Gjykatë gjen se është e vërtet se fillimisht me aktakuzën e Prokurorisë Themelore në Pejë PP/II.nr.729/2015 datë

29.6.2015, i dënuari ka qenë i akuzuar se ka uzurpuar lokalin – objekt i kësaj akuze, që nga viti 2010 e në vazhdim mirëpo më vonë gjatë procedurës ka bërë precizimin e aktakuzës duke përcaktuar kohën e kryerjes së veprës penale dhe atë pra nga viti 2015 e në vazhdim, gjë që e bënë pretendimin e pa bazuar.

Ndërkaq kjo gjykatë gjen se në gjendjen e tillë të vërtetuar faktike drejtë është aplikuar ligji penal kur i dënuari është shpallur fajtorë për veprën penale uzurpim i paligjshëm i pronës së paluajtshme nga nenin 332 par.1 të KPK, sepse në veprimet e tij përmbushen të gjitha elementet e veprës penale të cekur.

Duke u bazuar në të gjitha këto që u than më lart si dhe në bazë të nenit 437 të KPPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREM E KOSOVËS - PRISHTINË
Pml.nr.271/2017, më 14 mars 2017

Procesmbajtës,
Bujar Balaj

Kryetare e kolegjit,
Nesrin Lushta